



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## K R Y E T A R I

Nr. 574/8 Prot.

Tiranë, më 29/09/2016

### V E N D I M

**Nr.122, Datë 29/09/2016**

### PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË BULQIZË "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” të ushtruar në Bashkinë Bulqizë, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

##### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 582/10, datë 30.12.2012 dhe të ri kërkuara për zbatim me shkresën nr. 4371/58, datë 31.07.2013, u konstatua se:

Nga **7 masa organizative** të rekomanduara, ku në tre prej tyre, është kërkuar arkëtimi i shumës 3,485,322 lekë prej 62 subjekteve, janë zbatuar plotësisht 3 masa organizative. Pa zbatuar është 1 masë organizative, në proces zbatimi është 1 masë organizative dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative duke arkëtuar shumën 142,129 lekë nga 15 subjekte. Mbeten në proces arkëtim nga 47 subjekte vlera prej 3,343,193 lekë.

Nga **8 masa të rekomanduara për shpërbllimin e dëmit** në shumën 9,939,506 lekë nga 116 subjekte, janë zbatuar pjesërisht 4 rekomandime dhe të pa zbatuara 4 rekomandime. Në

total janë arkëtuar 4,072,498 lekë nga 48 subjekte, janë në proces arkëtimi nga 64 subjekte shuma 5,867,008 lekë.

Janë zbatuar të gjitha *masat disiplinore* të rekomanduara (nëntë).

### 1.1. **Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të ri kërkuara me shkresën nr. 4371/58, datë 31.07.2013, në zbatim të kërkesave ligjore.

Të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit të pa arkëtuar në shumën 5,867,008 lekë duke bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitorë.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

### 2. **Gjetje nga auditimi:**

Për fund vitin 2015, Bashkia Bulqizë ka nxjerrë pasqyrat financiare të konsoliduar përfshirë edhe gjendjen financiare për shtatë Njësitë Administrative (ish Komuna).

Llogaria e aktivitetit të bilancit 202 “*Shpenzime për studime ose kërkime*”, është me gjendje debitorë për vlerën 43,914,074 lekë, e cila në analizë të saj ka të evidentuar vlerën e shpenzimeve për studime projektive dhe oponenca teknike të kryera në vite.

Bashkia Bulqizë si dhe 7 ish Komunat, sot Njësi Administrative, nuk kanë hapur kartela inventari për evidentimin e studimeve dhe projekteve të investuara, në ngarkim të personave që i administrojnë këto studime dhe projekte.

Kjo praktikë, është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.

### 2.1. **Rekomandimi:**

Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës dhe të Shërbimeve, bazuar në të dhënat kontabël, të marrin masat dhe të organizojnë evidencën e inventarit të studimeve dhe projekteve të investuara në vite në Bashkinë Bulqizë dhe në 7 ish Komunat, sot Njësi Administrative. Administrimi i tyre të bëhet sipas procedurave ligjore, me kartela inventari, në ngarkim të personave që i kanë në administrim.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

### 3. **Gjetje nga auditimi:**

Për dy viteve 2014 dhe 2015 totali i borxhit të bizneseve ndaj Bashkisë Bulqizë, është në shumën 19,403,540 lekë, nga të cilat 16,823,160 lekë i përkasin biznesit të madh.

U konstatua se nga Bashkia Bulqizë, nuk janë vjelë të ardhura nga tatimet dhe taksat lokale ndaj 56 subjekteve që ushtrojnë aktivitetin për shfrytëzimin minerar ndaj të cilave për vitin 2015, llogaritet detyrim i pa paguar në shumën 9 milion lekë.

Performancë e ulët konstatohet edhe në vjeljen e tarifave dhe taksave nga familjarët;

Për vitin 2015, të ardhurat nga tarifatat dhe taksat familjare janë realizuar në masën 0.3%, ndërkohë që nga taksa mbi tokën bujqësore nuk është vjelë asnjë lek.

Për vjeljen e tyre, nuk janë aplikuar masat shtrënguese, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; nenit 90 të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 90 të Udhëzimit të MF nr. 24 datë 02.9.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

### 3.1. **Rekomandimi:**

Nga drejtoria e Financës dhe Sektorit Taksave në Bashkisë Bulqizë, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë **dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për biznese debitorë në vlerën**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a) **Tu dërgohen Bankave** urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

- b) **Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale** të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore në R.SH “ të ndryshuar.
- c) **Për subjektet të cilët** nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH “ të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).
- d) **Nga ana e Drejtorisë së Financës Bashkia Bulqizë, të** listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës të tokës nga fermerët dhe taksën e popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë (të Bashkisë Bulqizë dhe 7 njësitë Administrative), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimit me anë të Zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifatat etj.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**4. Gjetje nga auditimi:**

Në 4 raste, dosjet teknike të zbatimit të investimeve, rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

**4.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm teknik të dosjeve të investimeve, gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**5. Gjetje nga auditimi:**

Nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, *konkretisht:*

Nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij, nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, nuk janë miratuar gjurmët për auditimin, nuk janë identifikuar zonat me risk dhe rrjedhimisht nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, si dhe nuk është hapur regjistri i riskut.

**5.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë , të marrë masa dhe të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të punojë për implementimin e kërkesave ligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:**

Në Bashkinë Bulqizë, në strukturën e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), është emëruar vetëm një punonjës i cili mbulon edhe 7 Njësi Administrative. Nga ana e Sektorit të IMTV së Bashkisë Bulqizë, nuk disponohen të dhëna mbi gjendjen e territorit dhe ndërtimeve pa leje në 7 njësitë administrative të saj, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1. Sektori i IMTV-së, nuk ka kryer funksionet e veta të kontrollit të territorit në Njësitë Administrative, në kundërshtim me

kërkesat e ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin e ndërtimit dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

**6.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të rishikojë strukturën organizative të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), duke parë mundësinë e shtimit të personelit, me synim shkrirjen e funksionit të saj në të gjithë territorin e Bashkisë, në zbatim të kërkesave ligjore.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi mbi administrimin e dokumentacionit të Sektorit të IMTV-së, u konstatua se blloqet e procesverbaleve si; “konstatimi, pezullim punimesh, prishje objekti, dënim me gjobë, ekzekutive dhe plotësim dokumentacioni teknik ligjor”, nuk janë trajtuar si letra me vlerë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me verë”, i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.04.2011, me VKM nr. 393, datë 18.6.2014, pika 1 dhe 2.

**7.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të marrë masa që blloqet e procesverbaleve të cilat përdoren nga Sektori i IMTV-së, të bahen hyrje në magazinë dhe të administrohen në mënyrë kontabile si letra me vlerë për të mos lënë shteg për abuzime të mundshme.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Bulqizë, nuk ka filluar nismën për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe të dhënat e lejeve të shfrytëzimit nuk janë hedhur në Regjistrin e Territorit, veprim në kundërshtim me nenin 54, 55 e 56, të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

**8.1. Rekomandimi:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Bulqizë, të marrë masa të fillojë nismën për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe të hedhë në Regjistrin e Territorit të dhënat e lejeve të shfrytëzimit të miratuara dhe të dërguara për regjistrim në ZVRPP Bulqizë.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Bulqizë, në dosjet e lejeve të shfrytëzimit, nuk ka depozituar deklaratën e përputhshmërisë që konfirmon kryerjen e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë, dokumentacioni tekniko-ligjor që është dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë është dërguar me mangësi. Në dosjen e objekteve publike për të cilët është miratuar leje ndërtimi, nuk ndodhen kërkesa si dhe dokumentacioni në dosje është i pa inventarizuar, veprim në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, kreu II, neni 9 dhe neni 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenin 79, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar, ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” të ndryshuar, pikën 9 e 10 neni 3, pikën 4 neni 4 dhe neni 8, të VKM nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.

**9.1. Rekomandimi:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Bulqizë, të marrë masa, të kërkojë nga subjektet ndërtuese deklaratën e përputhshmërisë që konfirmon kryerjen e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë, të plotësoj me dokumentacionin tekniko-ligjor dosjet për të cilat lëshohet leje shfrytëzimi, si dhe të bëjë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë miratuar lejet e shfrytëzimit.

*Në vijimësi*

## **10. Gjetje nga auditimi:**

Bashkia Bulqizë, nuk ka bërë inventarizimin e pronave dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Bulqizë. Njësitë Administrative Shupenzë, Gjoricë, Zerqan, Fushë Bulqizë, Ostren, Trebisht dhe Martanesh, nuk disponojnë të dhëna mbi gjendjen e pronave të miratuar sipas listës që kalojnë në përdorim ose në pronësi të ish-njësive të pushtetit vendor. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

### **10.1. Rekomandimi:**

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, Shërbimeve, Emergjencave Civile dhe Rrugëve Rurale dhe Drejtoria e Pyjeve, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit Drejtoria e Pyjeve, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit në Bashkinë Bulqizë të marrë masa, të bëjë inventarizimin e pronave dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Bulqizë. Njësitë Administrative Shupenzë, Gjoricë, Zerqan, Fushë Bulqizë, Ostren, Trebisht dhe Martanesh të hartojnë të dhënat mbi gjendjen e pronave të miratuar në përdorim ose në pronësi të ish-njësive të pushtetit vendor.

*Në vijimësi*

## **11. Gjetje nga auditimi:**

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të lejeve minerare të lëshuara nga MEI, me aktivitet në territorin e Bashkisë Bulqizë dhe ish-Komunat, Shupenzë, Gjoricë, Zerqan, Fushë Bulqizë, Ostren, Trebisht dhe Martanesh, rezultoi se 119 subjekte ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi të sipërfaqeve pyjore/ kullosore, prej 28,7 km<sup>2</sup> ose 2,870 ha, për të cilët bashkia/ish komunat nuk kanë lidhur kontrata dhe nuk ka ushtruar kontrole nëse këto sipërfaqe shfrytëzohen ose jo, për të bërë të mundur realizimin e të ardhurave nga qiratë në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2 “Tarifat dysHEME për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullosorë publik për ushtrimin e veprimtarive” pika 9/6, duke shkaktuar të ardhura të munguara për Bashkinë Bulqizë.

### **11.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë të marrë masa për ngritjen e një grupi punë me specialistë të fushës, për evidentimin dhe saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme në pyje e kullota, duke lidhur kontrata ligjore para noterit publik, në përputhje me germën “F” të nenit 39 dhe nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, si dhe pikat 3, 4 dhe 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiratë.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

## **12. Gjetje nga auditimi:**

Në Bashkinë Bulqizë, u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” i ndryshuar.

### **12.1. Rekomandim:**

Bashkia Bulqizë t'i kërkojë Ministrisë së Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullor.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

### **13. Gjetje nga auditimi:**

Operatorët ekonomik “██████████” sh.a, “██████████” sh.a dhe “██████████” sh.a., nuk kanë paguar detyrimet për taksa e tarifave vendore në ish Komunat Fushë-Bulqizë, Zerqan dhe Shupenzë, në kundërshtim me pikën 5.1 të kontratës së qirasë, dhe me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 2, 7, “Taksa mbi pasurinë e paluajtshme , në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore taksa për zënie e hapësirave publike etj.”.

### **13.1. Rekomandim:**

Bashkia Bulqizë të rishikojë pikën 5.1 të kontratave të qirasë të nënshkuara me “██████████” sh.a, “██████████” sh.a dhe “██████████” sh.a., me qëllim që subjektet qiramarrëse të paguajnë detyrimet për taksa e tarifave vendore

*Menjëherë*

### **14. Gjetje nga auditimi:**

Nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale për dhënie me qira dhe në përdorim të fondit pyjor e kullor publik në vlerën **4,685,848 lekë**, 4 subjektet si më poshtë :

- “██████████” sh.p.k, në vlerën 2,656,884 lekë
- “██████████ & ██████████” sh.p.k, në vlerën 819,884 lekë.
- “██████████ ██████████” sh.p.k në vlerën 130,000 lekë
- “██████████”, në vlerën 1,000,000 lekë
- “██████████”, në vlerën 79,080 lekë.

### **14.1. Rekomandim:**

Nga Bashkia Bulqizë të rishikohen kontratat e lidhura me subjektet për dhënie me qira dhe në përdorim të fondit pyjor e kullor publik si dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtim detyrimeve sipas kontratave në 4 subjekte **në vlerën 4,685,848 lekë**.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në kontratën e qirasë datë 03.01.2015, e lidhur nga ish-Komuna Martanesh me z. K.K. për 48 m<sup>2</sup>, rezulton se vlera e qirasë është llogaritur vetëm për 31 m<sup>2</sup>, duke sjellë një dëm ekonomik prej 102,000 lekë, e llogaritura (48 m<sup>2</sup> - 31 m<sup>2</sup>) x 50 lekë x 12 muaj = 10,200 lekë/vit x 10 vjet = 102,000 lekë.

### **15.1. Rekomandim:**

Bashkia Bulqizë të rishikojë kontratën e qirasë datë 03.01.2015, të nënshkruar nga ish Komuna Martanesh, duke saktësuar sipërfaqen e dhënë me qira, për rrjedhojë edhe vlerën e qirasë dhe të kërkojë diferencën e pa llogaritur, në vlerën prej 102,000 lekë.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**16. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Bulqizë, është organizuar dhe funksionon struktura e Policisë Bashkiake, në përbërjen e së cilës janë kryeinspektori dhe 5 punonjës policie. Punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë me formim policor, nuk janë marrë në punë me komision të ngritur sipas kërkesave ligjore si dhe nuk janë pajisur me uniformën e policisë bashkiake. Aktiviteti i policisë bashkiake, nuk është i dokumentuar me programe pune vjetore e mujore si dhe me urdhra të miratuara nga titullari i bashkisë. Sa më sipër janë në

kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake" i ndryshuar, neni 4 dhe Rregulloren e Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake dhe Komunës miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendorë dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 "Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës", pika 11.

#### **16.1. Rekomandimi:**

Të merren masa që të riorganizohet struktura e Policisë Bashkiake, me personel të kualifikuar, të disiplinohet aktiviteti i saj me programe dhe detyra të qarta të urdhëruara nga Titullari i Bashkisë e Këshilli Bashkiak si dhe të merren masa, të pajisen punonjësit e policisë me uniformën përkatëse. sipas kërkesave ligjore

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

## **B. MASAT PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 59,376,399 lekë, si më poshtë:**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Në 48 raste qiramarrësit nuk kanë paguar qiranë e truallit në shumën **21,216,000 lekë**, e llogaritur 5,440 m<sup>2</sup>x100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj x 39 muaj (01.10.2012-31.12.2015), në kundërshtim me 6 vendimet e Këshillit të Bashkisë nr. 51, datë 21.12.2009, nr. 08, datë 26.03.2010, nr. 10, datë 24.11.2010, nr. 50, datë 30.11.2010, nr. 13, datë 22.04.2011, nr. 22, datë 05.08.2011 dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

#### **1.1. Rekomandimi:**

Të merren masa, e të kryhen kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit me vlerën **21,216,000 lekë**, e cila përfaqëson mungesë të ardhurash nga mos pagesa e qirave të truallit, nga 48 qiramarrës sipas listës në Raportin Përfundimtar të Auditimit faqe 248-260.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

### **2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i llogarisë së aktivitetit të bilancit financiar të konsoliduar nr. 215 "Mjete transporti" me gjendje debitore 17,012,634 lekë, u konstatua se në Bashkinë Bulqizë, nuk disponohen fletët e inventarëve për mjetet e transportit që ish- Komunitat kanë pasqyruar në përmbledhësen e inventarëve me arkivimin pranë kësaj Bashkie të pasqyrave financiare në muajin Korrik, 2015 në kuadër të reformës administrative.

Në total, për Bashkinë Bulqizë dhe për Njësitë Administrative të saj, nuk disponohen kartela inventari mbi gjendjen fizike **për 14 mjete transporti për vlerën kontabël 7,747,689 lekë.**

Mungesa e dokumentacionit të plotë për llogarinë e inventarit nr. 215 "Mjete transporti" si dhe mungesa fizike e këtyre mjeteve **përbën dëm ekonomik** për Bashkinë Bulqizë,

veprime në shkelje e kërkesave ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III pikat 26, 35/b, 35/c, Kap IV, pika 73 si dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

### **2.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të marrë masat, duke ngritur një komision me specialistë të fushës, të identifikojë personat përgjegjës debitorë për mungesën e mjeteve të transportit duke ndjekur inventarizimet në vite deri në origjinën e krijimit të asetit.

Në mungesë të dokumentacionit kontabël ligjor, të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, **arkëtimi i vlerës 7,747,689 lekë nga Titullarët e Njësive Vendore dhe Përgjegjësit e Financës:**

- **Z. M.D.** me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Bulqizë, R.B. me detyrë Përgjegjës i Financës Bashkia Bulqizë e S.K. ish Përgjegjës i Financës Bashkia Bulqizë, për mungesën e 3 mjeteve në vlerën 1,664,543 lekë,
- **Z. F.B.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Trebisht, aktualisht Administrator në Njësinë Trebisht dhe K.A. me detyrë ish Përgjegjëse e Financës Komuna Trebisht, për mungesën e 2 mjeteve në vlerën 2,073,101 lekë.
- **Z. R.R.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Ostren dhe Sh.K. me detyrë ish Përgjegjëse i Financës Komuna Ostren, për mungesën e 9 mjeteve në vlerën 4,010,045 lekë.

*Menjëherë*

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Kontraktuesi “**[REDAKTUAR]**” shpk, nuk ka zbatuar kushtet e kontratës nr. 40, datë 12.10.2012 të lidhur me ish Komunën Trebisht për kontratën me objekt: “Palestër e shkollës 9-vjeçare Trebisht”. Janë financuar punime në vlerën 1,337,048 lekë pa tvsh, ndërsa vlera e kontratës është 8,283,326 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe UKM nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”.

Nuk janë kryer punimet sipas preventivit, projekt zbatimit dhe ofertës së paraqitur për vlerën **6,946,278 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** të arkëtueshëm.

### **3.1. Rekomandim:**

Bashkia Bulqizë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **6,946,278 lekë** pa t.v.sh nga operatori ekonomik “**[REDAKTUAR]**” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës nr. 40, datë 12.10.2012 të lidhur me ish Komunën Trebisht, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik punë të pa kryer.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

### **4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, rezultoi se në listë pagesat mbi shpërblimin e këshilltarëve të Këshillit të Bashkisë Bulqizë dhe të ish komunave, janë paguar edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, për 92 këshilltarë, **në shumën 5,927,328 lekë, shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Njësive Vendore** si më poshtë:

- Bashkia Bulqizë për 32 persona në shumën **1,924,252 lekë** sipas listës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
- Njësia Administrative Shupenzë (ish Komuna Shupenzë), për 15 persona në shumën **1,269,993 lekë**, sipas listës bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.
- Njësia Administrative Zerqan (ish Komuna Zerqan), për 15 persona në shumën **1,351,350**



**lekë**, sipas listës bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

- Njësia Administrative Trebisht (ish Komuna Trebisht), për 15 persona në shumën **1,033,847 lekë**, sipas listës bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.
- Njësia Administrative Martanesh (ish Komuna Martanesh), për 15 persona në shumën **347,886 lekë**, sipas listës bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**4.1. Rekomandim:**

Të merren masat dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **5,927,328 lekë** nga 92 personat përfitues, ish anëtarë të këshillave të njësive vendore, sipas listës emërore bashkëngjitur Projekt Raportit të Auditimit.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**5. Gjetje nga auditimi:**

Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Furnizim vendosje pemësh + sistemim gjelbërimi i akseve rrugore + degëzim “Ruga Skënderbeu dhe Ruga 18 Shkurti” Bashkia Bulqizë”, rezultoi se: Operatori Ekonomik “” shpk, nuk ka zbatuar plotësisht kërkesat e projektit pasi nuk janë respektuar sipas projektit, distancat ndërmjet pemëve-shkurre, lartësia e kurorës së drurit (trung i vetë krasitur) si dhe lartësia e drurëve pas vendosjes në gropë (implantimit), **me dëm ekonomik në vlerën 5,190,750 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratës nr. 1482 prot., datë 26.11.2014. (trajtuar më hollësisht në faqet 72-170 të raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandim:**

Bashkia Bulqizë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **5,190,750 lekë** pa t.v.sh nga operatori ekonomik “” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas kontratës nr 1482 Prot., datë 26.11.2014 lidhur me Bashkinë Bulqizë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik punë të pa kryer, si rrjedhojë e mos zbatimit të projektit në lidhje me distanca ndërmjet pemëve dhe lartësisë së kurorës së drurit nga sipërfaqja e tokës.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**6. Gjetje nga auditimi:**

Në kontratën e qirasë me subjektin: “” shpk, nuk është përfshirë sipërfaqja pyjore klasifikuar “Inproduktive” prej 1,5737 ha, duke shkaktuar dëm ekonomik për Njësinë Administrative Zerqan në vlerën për 10 vjet: 1.5737 ha x 176,000 lekë/ha x 10/vjet = **2,769,712 lekë** të arkëtueshëm nga OE “” shpk.

**6.1. Rekomandim:**

Të merren masa, të kryhet kontabilizimi i detyrimit duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën ose **2,769,712 lekë**, nga OE “” shpk.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren në objektin: “**Rikonstruktion objekti ekzistues Shkolla 9-Vjeçare “Xhevdet Doda” + ndërtime shtesë + nyje sanitare dhe palestër**”, rezultuan diferenca paguar më tepër për vlerën **1,831,760 lekë pa TVSH me dëm ekonomik**, nga të cilat vlera 353,456 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt, vlera 928,899 lekë pa TVSH, si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve e pa u shoqëruar me çmimin përkatës, vlera 549,405 lekë si pasojë e përfshirjes në situacionin përfundimtar të t.v.sh-së për pajisjet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën për punë publike pa numër protokolli, datë 23.01.2015.

**7.1. Rekomandim:**

Nga Bashkia Bulqizë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,831,760 lekë pa TVSH**,

nga të cilat vlera 353,456 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt, vlera 928,899 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, vlera 549,405 lekë si pasojë e përfshirjes në situacionin përfundimtar të t.v.sh-së për pajisjet nga OE “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike pa numër protokolli, datë 23.01.2015 në objektin: **“Rikonstruksion Objekti Ekzistues Shkolla 9-Vjeçare “Xhevdet Doda” + Ndërtime Shtesë + Nyje Sanitare dhe Palestër”** Bashkia Bulqizë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë së Qeverisjes Vendore si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e punimeve.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:**

Në objektin **“Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Gjoricë dhe Ndërtim Palestër”**, ish-Komuna Gjoricë, Bulqizë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **1,725,871 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik**, nga të cilat vlera **1,646,437 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 79,434 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës**, në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën për punë publike nr. 353 Prot., datë 22.09.2014.

**8.1. Rekomandim:**

Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,725,871 lekë pa TVSH**, nga të cilat vlera **1,646,437 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 79,434 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës** nga BOE “██████████” shpk dhe “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 353 Prot., datë 22.09.2014 në objektin: **“Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Gjoricë dhe Ndërtim Palestër”**, ish-Komuna Gjoricë, Bulqizë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e e mangësive në zbatimin e punimeve.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:**

Në objektin: **“Sistemim-Asfaltim Rruge, Blloku i Poshtëm, Lagja “Gjeologu”**, Bashkia Bulqizë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan paguar më tepër në vlerën **1,459,595 lekë pa TVSH me dëm ekonomik**, nga të cilat vlera **863,495 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 596,100 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës**, në kundërshtim preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën për punë publike nr. 813 prot., datë 26.06.2014.

**9.1. Rekomandim:**

Nga Bashkia Bulqizë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,459,595 lekë pa TVSH**, nga të cilat vlera **863,495 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 596,100 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës** nga OE “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 813 prot., datë 26.06.2014 në objektin: **“Sistemim-Asfaltim Rruge, Blloku i Poshtëm, Lagja “Gjeologu”** Bashkia Bulqizë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë së Qeverisjes Vendore si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e punimeve.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:**

Në fund të vitit 2012, nga Bashkia Bulqizë, janë shpërblyer nga fondi i veçantë 109

punonjës **për vlerën neto 935,253 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 849, datë 6.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar pika 9.

**10.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës **935,253 lekë** nga personat 109 përfitues, referuar listës emërore sipas përcaktimeve në faqen 54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

*Menjëherë*

**11. Gjetje nga auditimi:**

Nga Bashkia Bulqizë, është paguar subjekti “” shpk për kryerjen e punimeve shtesë në objektin “Terrene sportive e sistemim i shkollës së vjetër fshati Godvi” në **shumën 738,324 lekë**. Për kryerjen e punimeve shtesë, mungon argumentimi teknik, mungon kërkesa për punimet shtesë dhe miratimi i tyre nga projektuesi.

Çmimet e aplikuara në situacionin e punimeve shtesë, janë më të mëdha se sa ato të situacionit fillestar. Nuk ka akt marrje në dorëzim të punimeve shtesë, veprime në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 7 dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 35, 36, 42, 43, 44.

**11.1. Rekomandimi:**

Të procedohet sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerë **738,324 lekë** nga subjekti përfitues “” shpk.

*Menjëherë*

**12. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Zerqan, në vitin 2013 është paguar subjekti “” shpk **në shumën 497,280 lekë** për objektin: “Shtesë Punimesh Ndërtimi Terrene Sportive dhe ndërtim murri”. Për këtë shtesë punimesh, nuk ka akt marrje në dorëzim të punimeve, nuk ka dokumentacion mbi argumentim e kryerjes së shtesës së punimeve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58 si dhe të nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

**12.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës **497,280 lekë** nga subjekti “” shpk .

*Menjëherë*

**13. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Ostren, në vitin 2015, është paguar subjekti “” shpk **në shumën 415,920 lekë** për “Ndërtim i urës Tucep”. Për këtë shpenzim, mungojnë bashkëngjitur urdhër pagesës, situacioni për kryerjen e punimeve dhe procesverbal mbi marrjen në dorëzim të objektit, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58 si dhe të nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

**13.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës **415,920 lekë** nga subjekti “[REDACTED]” shpk.

*Menjëherë*

**14. Gjetje nga auditimi:**

Në objektin: “Sistemim-Asfaltim Rruga Allmete-Duriçe-Alle, Lagja Vajkal 2” Bashkia Bulqizë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan paguar më tepër në vlerën **352,380 lekë pa TVSH me dëm ekonomik**, për punime të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Bulqizë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. B.M. neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3 dhe Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

**14.1. Rekomandim:**

Nga Bashkia Bulqizë, të merren masa për arkëtimin e vlerës **352,380 lekë pa TVSH** për punime të pakryera në fakt nga OE “[REDACTED]” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 860 prot., datë 18.06.2015 në objektin: “Sistemim-Asfaltim Rruga Allmete-Duriçe-Alle, Lagja Vajkal 2” Bashkia Bulqizë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë së Qeverisjes Vendore si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e punimeve.

*Menjëherë*

**15. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Zerqan, në vitin 2013 është paguar subjekti subjekti “[REDACTED]” shpk në shumën 1,342,920 lekë për “Ndërtim të Lulishtes Qendra e Fshatit Zerqan”.

Referuar dokumenteve të tenderit dhe kontratës të sipërmarrjes së punimeve, ky investim është dorëzuar nga sipërmarrësi me vonesë 4,5 muaj ose 135 ditë vonesë.

Nga ish Komuna Zerqan, nuk është llogaritur dhe ndalur penalteti për vonesën e dorëzimit të punimeve në shumën **335,730 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dokumente standard të tenderit dhe kontratës të lidhur midis palëve.

**15.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës **335,730 lekë** nga subjekti “[REDACTED]” shpk .

*Menjëherë*

**16. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Shupenzë, në vitin 2014 është paguar subjekti “[REDACTED]” shpk për objektin “Ndërtim i shkollës cikli i ulët fshati Topojë”.

Subjekti është paguar më tepër se sa vlera e situacionit të kryerjes së punimeve **në vlerën 179,550 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, neni 7, UKM nr. 2, datë 13.5.2015 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58.

**16.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës **179,550 lekë** nga subjekti përfitues

*Menjëherë*

**17. Gjetje nga auditimi:**

Nga Bashkia Bulqizë, janë kryer shpenzime për paketë turistike 3 ditore Bulqizë-Budva (Mali i Zi) dhe kthim për 23 persona *në shumën 165,499 lekë*.

Për këtë shpenzim, nuk ka listë emërore të nxënësve udhëtues dhe nuk ka akt marrje në dorëzim të shërbimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 35, 36, 42, 43, 44.

**17.1. Rekomandimi:**

Të procedohet sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerë *165,499 lekë* nga urdhëruesit e kryerjes së shpenzimit dhe subjektit përfitues:

- **Z. M.D.** për 82,749 lekë,
- **Z. S.K.** për 82,749 lekë,

*Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Ostren, në vitin 2014, është paguar subjekti “[REDACTED]” shpk *në shumën 156,000 lekë* për “shpenzime për mirëmbajtje e rrugëve e veprave ujore”.

Për këtë shpenzim, mungojnë bashkëngjitur urdhër pagesës, situacioni për kryerjen e punimeve dhe procesverbal mbi marrjen në dorëzim të objektit, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58 si dhe të nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” (trajtuar më hollësisht në faqet 44-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës *156,000 lekë* nga subjekti “[REDACTED]” shpk.

*Menjëherë*

**19. Gjetje nga auditimi:**

Në ish Komunën Gjoricë, në vitin 2012, janë paguar 17 punonjës të aparatit të komunës nga fondi i veçantë shpërblim për fundin e vitit, në shumën totale neto *153,000 lekë*, në shkelje të kërkesave të VKM nr. 849, datë 6.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar pika 9.

**19.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës *153,000 lekë* nga 17 personat përfituesi sipas listës në faqen 52-88 të Projekt Raportit të Auditimit.

*Menjëherë*

**20. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Ostren, në vitin 2015, është paguar subjekti “[REDACTED]” shpk *në shumën 103,200 lekë* për “pastrim të mbetjeve urbane për periudhën janar- qershor 2015”.

Mungon preventivi mbi llogaritjen e fondit limit si dhe nuk ka situacion dhe as procesverbal me komision mbi kryerjen e këtij shërbimi, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58.

**20.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës *103,200 lekë* nga subjekti “[REDACTED]” shpk.

*Menjëherë*



**21. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Ostren, në vitin 2012, janë shpërblyer nga fondi i veçantë 15 punonjës të administratës për *shuam totale neto 135,000 lekë*.

Shpërblimi i punonjësve nga fondi i veçantë, është në shkelje të kërkesave të VKM nr. 849, datë 6.12.2012 Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, të ndryshuar pika 9.

**21.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës *135,000 lekë* nga 15 personave përfitues.

*Menjëherë*

**22. Gjetje nga auditimi:**

Në kontratën e qirasë datë 01.01.2014 lidhur nga ish Komuna Martanesh, me subjektin nuk është përfshirë sipërfaqja pyjore klasifikuar “Inproduktive” prej 1.23 ha, duke shkaktuar *dëm ekonomik në vlerën 76,260 lekë/vit* (1.23 ha x 62000 lekë =76,260 lekë/vit) (trajtuar më hollësisht në faqet 189-200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1. Rekomandim:**

Të merren masa, e të kryhen kontabilizimi duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit me vlerën ose *76,260 lekë* në vit, nga OE “          ” sh.p.k.

*Brenda Muajt Dhjetor 2016*

**23. Gjetje nga auditimi:**

Nga ish Komuna Ostren, në vitin 2013, është paguar subjekti “          ” shpk në *shumën 72,500 lekë* për “Rikonstruksion Ujësjellësi Radovesh”.

Për këtë shpenzim, mungojnë bashkëngjitur urdhër pagesës, situacioni për kryerjen e punimeve dhe procesverbal mbi marrjen në dorëzim të objektit, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58 si dhe të nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

**23.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës *72,500 lekë* nga subjekti “          ” shpk.

*Menjëherë*

**24. Gjetje nga auditimi:**

Në ish-Komunën Fushë-Bulqizë, janë kryer shtese punimesh për objektin “mirëmbajtje rruga Dragu+ Nivelim urash Vendore” *në shumën 64,120 lekë*.

Për shtesën e punimeve të kontraktuara, nuk ka dokumentacion justifikues si: Kërkesa nga investitori për punimet shtesë, preventivi i punimeve si dhe kontrata shtesë, në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35/a, b, c dhe 36.

**24.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës *64.120 lekë* nga përfituesi personi fizik S.H.

*Menjëherë*

**25. Gjetje nga auditimi:**

Në ish Komunën Fushë-Bulqizë, janë kryer shtesë punimesh *në shumën 63,600 lekë* për objektin “mirëmbajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore”.

Për shtesën e punimeve, nuk ka dokumentacion justifikues si: miratimi dhe argumentimi i

shtesë së projekti. Mungon kontrata fillestare dhe shtesa e kontratës. Mungon akti i marrjes në dorëzim të objektit me komision, në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35/a, b, c dhe 36.

#### **25.1. Rekomandimi:**

Bashkia Bulqizë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës **63,600 lekë** nga përfituesi subjekti S.H.

*Menjëherë*

### **C. MASA DISIPLINORE:**

#### **C/1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dhënien e masave disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, për 7 punonjës si më poshtë:

#### **1. Zj. Sh.O.** me detyrë specialiste e financës në Bashkinë Bulqizë, pasi:

- Në ish Komunën Shupenzë ku ka qenë Përgjegjëse e Zyrës së Financës, janë paguar shpërblime të anëtarëve të Këshillit të ish Komunës Shupenzë **në shumën 1,269,993 lekë**, pa pasur listë prezencë të pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit të Komunës, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.
- Në ish Komunën Shupenzë, janë kryer shpenzime **në shumën 769,550 lekë**, në shkelje të disiplinës financiare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58 dhe UKM nr. 2, datë 13.5.2015 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

#### **2. Z. R.B.** me detyrë Drejtor i Financës, Bashkia Bulqizë nga data 02.10.2015 e në vazhdim, pasi:

- Janë paguar shpërblime të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Bulqizë për periudhën 2013-2015 **në shumën 1,924,252 lekë**, pa pasur listë prezencë të pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit të Komunës, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.
- Në mbylljen e bilancit financiar të vitit 2015, nuk janë evidentuar mungesat në mjetet e transportit nga ish komunat sot njësi Administrative të Bashkisë Bulqizë për 16 mjete në vlerën kontabile 11,865,684 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

#### **3. Z. F.Z.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Fushë-Bulqizë, aktualisht Administrator në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë, pasi:

- Janë kryer shpenzime operative në ish Komunën Fushë-Bulqizë në shumën **927,731 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimi”, Kreu I, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35/a, b, c dhe 36, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimi”, Kreu I, neni 7.
- Në ish Komunën Fushë-Bulqizë, sot Njësi Administrative, nga mbyllja e kësaj Njësie, nuk është evidentuar mungesa e një mjeti transporti me vlerë kontabile 997,800 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.
- 4. Z. V.B.** me detyrë specialiste e Zyrës së Urbanistikës, në cilësinë e ish Përgjegjëse e Sektorit të Taksave për periudhën 26.07.2013- 13.08.2014, pasi:
  - Për 56 bizneset që ushtrojnë aktivitetin për shfrytëzim minerar në Bashkinë Bulqizë, nga Zyra e Tatim Taksave, nuk është proceduar sipas ligjit për vjeljen e detyrimeve lokale si; njoftimi periodik i debitorëve, bllokimi aktiviteti, bllokimi i llogarisë bankare, rakordimi me agjentet tatimore si Drejtoria Rajonale e Tatimeve si dhe Drejtoria Rajonale e Shfrytëzimit të Automjeteve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; nenit 90 të ligjit nr. 9920 date 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 90 të Udhëzimit të MF nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- 5. Zj. A.H.** me detyrë Specialiste e Menaxhimit të Pronave dhe në cilësinë e ish Përgjegjëse e Sektorit të Pronave për periudhën 16.06.2011 deri më 18.01.2015;
- 6. Z. L.D.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave nga data 18.01.2015 e në vazhdim; pasi:
  - Në menaxhimin e pronave, nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 37, 42, 60, 74, ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar nenet 8, 10, 15, 16 si dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 37, 42, 60, 74, VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2 “Tarifat dysHEME për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullosorë publik për ushtrimin e veprimtarive” pika 9/6, duke shkaktuar të ardhura të munguara për Bashkinë Bulqizë.
- 7. Z. F.B.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Trebisht, aktualisht Administrator në Njësinë Administrative Trebisht, pasi:
  - Janë paguar shpërblime të anëtarëve të Këshillit të ish Komunës Trebishtë në shumën 1,033,847 lekë, pa pasur listë prezencë të pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit të Komunës, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.
  - Në ish Komunën Trebisht, sot Njësi Administrative, nga mbyllja e kësaj Njësie, nuk është



evidentuar mungesa e dy mjeteve transporti me vlerë kontabile 2,073,101 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe cdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

### **D.1 Për Bashkinë Bulqizë:**

1. Nga Bashkia Bulqizë të merren masa, që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 100,000 lekë për Ing. G.I.** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:
  - Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “**Rikonstrukcion i Shkollës 9-Vjeçare Gjoricë dhe Ndërtim Palestër**”, ish-Komuna Gjoricë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,725,871 lekë pa TVSH**, nga të cilat vlera **1,646,437 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 79,434 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

*Menjëherë*

2. Nga Bashkia Bulqizë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 500,000 lekë për ing. T.S.** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:
  - Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “**Rikonstrukcion i Shkollës 9-Vjeçare Gjoricë dhe Ndërtim Palestër**”, ish-Komuna Gjoricë, Bulqizë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,725,871 lekë pa TVSH**, nga të cilat vlera **1,646,437 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 79,434 lekë pa TVSH si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

*Menjëherë*

### **D. 2. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 17, 18, 22, 24, 26, 27, 28, 29, datë 15.07.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, 40 punonjësve si më poshtë:**

**I. Për Bashkia Bulqizë për 7 punonjës si më poshtë:**

1. **Zj. Zh.D.** me detyrë jurist, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT (aktualisht punonjëse në Bshkinë Bulqizë), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjecare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Allmete-Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”;
2. **Zj. P.K.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë ), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjecare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Allmete –Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”;
3. **Zj. L.T.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjecare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Allmete –Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”;
4. **Z. A.L.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë ), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjecare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Allmete –Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”;
5. **Z. S.K.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjecare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Allmete –Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”;
6. **Z. B.Sh.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht punonjës në Bashkinë Bulqizë), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjecare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Allmete –Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”;
7. **zj. E.N.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të NJDH (aktualisht jashtë institucionit pa adresë), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjeçare “Xhevdet Doda”;
  - “Sistemim asfaltim Rruga Blloku i Poshtëm, Lagja Gjeologu, Bashkia Bulqizë”;

**Për shkeljet e mëposhtme:**

- a) Në tenderin me objekt: **“Rikonstruksion i objektit ekzistues shkolla 9-vjeçare “Xhevdet Doda”,** zhvilluar më datë 25.10.2015, me fond limit 44,335,300 lekë, i fituar nga OE “XXXXXXXXXX” shpk me vlerë 44,193,560 lekë pa tvsh, lidhur kontrata nr. 34, datë 23.01.2015, *u konstatua se:*



publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve.

Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

S`kualifikimi i operatorit ekonomik “**[REDACTED]**” sh.p.k është bërë në kundërshtim me nenin 56, të LPP, kreun V pika 4(g) të RPP dhe kreun 3 vlerësimi i ofertave, pikat 3.4, 3.5 të DST. Sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit vlera limit e kontratës është 20,000,000 leke pa tvsh e për rrjedhojë zbritjet e mundshme janë në vlerën 8,000,000 leke e llogaritur 20,000,000 leke x40%. Oferta e operatorit ekonomik është 12,778,530 leke ose rreth 64% e fondit limit.

- c) Në tenderin me objekt: **“Sistemim asfaltim Rruga Allmete –Durice-Alle, lagja Vajkal 2, Bashkia Bulqizë”**, zhvilluar më datë 11.05.2015, me fond limit 16,136,254 lekë, i fituar nga OE “**[REDACTED]**” shpk me vlerë 12,222,222 lekë pa tvsh., lidhur kontrata datë 18.06.2015, u konstatua se:

Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, për arsye se: kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve.

Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

KVO nuk ka zbatuar nenin 56 të LPP, në të cilin përcaktohet se nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalish të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre. Oferta do të cilësohet anomalish e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP, për arsye se sipas klauzolës së përcaktuar në DST që në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, oferta vlerësohet anomalish e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme për rrjedhojë OE “**[REDACTED]**” është ofertë anomalish e ulët, ç`ka ngarkon me përgjegjësi KVO-në.

## **II. Për Ish- Komuna Shupenzë për 6 punonjës si më poshtë:**

1. **Zj. Sh.O.** me detyrë ekonomiste, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT (aktualisht punonjëse në Bashkinë Bulqizë);
2. **Z. Sh.M.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT

(aktualisht jashtë institucionit pa adresë);

3. **Z. M.M.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë);
4. **Z. G.T.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë);
5. **Z. B.S.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë);
6. **Z. V.B.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë) për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Furnizim me uje i disa fshatrave të Komunës Shupenzë”,
  - “Ndërtim shkolle CU-kat fshati Topojan”;për shkeljet e konstatuara sa vijon:

- a) Në tenderin me objekt: **“Furnizim me ujë i disa fshatrave të Komunës Shupenzë”**, zhvilluar më datë 18.08.2012, kontrata lidhur datë 04.10.2012 me fond limit 64,076,472 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “” shpk, u konstatua se:

NJHDT nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, sipas Rregullave të Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, në kualifikimin e ofertuesve për **vlerën 11,938,133 lekë**.

NJHDT nuk ka përcaktuar saktë kërkesat e veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi, bazuar në përcaktimet e VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë” duke sjellë diferencë në ofertën fituese më tepër për vlerën 11,938,133 lekë.

**OE “” shpk**, nuk ka plotësuar kriteret në lidhje me Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, për arsye se nuk ka në licencën e shoqërisë kategorinë NS-8/B (Ndërtime para fabrikat NS-9/A (Punime strukturore speciale) NS-10/A (Shtresa dhe mbi struktura speciale), beton arme, struktura metalike dhe druri) dhe NS-18/B (Punime topo gjeodezie).

**KVO-ja** ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kritere të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në këtë procedure. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kritereve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues BOE “ & ” në kundërshtim me Neni 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç.

Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që **11,938,133 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

- b) Në tenderin me objekt: **“Ndërtim shkolle CU-kat fshati Topojan”**, zhvilluar më datë 14.06.2-13, kontrata lidhur datë 22.08.2013 me fond limit 6,125,000 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “” shpk me vlerë 5,453,005, fituar me diferencë nga fondi limit për 671,995 lekë, u konstatua se:

NJHDT nuk ka vendosur saktë kërkesat e veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi, bazuar në përcaktimet e bëra në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e



prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.

Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, konform me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve **në vlerën 654,405 lekë**.

OE fitues nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës për arsye se në licencë nuk ka kategoritë e punimeve NS-14/ A (impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV) dhe NS -18/ A (punime topo gjeodezie).

**KVO-ja** ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriteret të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues BOE “XXXXXXXXXX” në kundërshtim me nenin 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që **654,405 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

### **III. Ish Komuna Zerqan për 7 punonjës si më poshtë:**

1. **Z. M.Z.** me detyrë ish specialist, në cilësinë e Kryetarit e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë);
2. **Z. N.Xh.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT e Kryetarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë) ;
3. **Z. F.P.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë) ;
4. **Z. E.P.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë);
5. **Z. V.K.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë)  
për procedurat e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstrukcion i rrugës Tre çezmat-Zerqan (Faza I)”;
  - “Ndërtim Ujësjellësi në fshatin Zall-Sopot dhe ndërtim murre guri, kanale betoni dhe rruge auto, ndërtim vend depozitimi për mbetjet urbane, rrethim lulishtja në fshatrat e Komunës”;
6. **Z. B.Sh.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë) për procedurën e prokurimit me objekt:
  - “Rikonstrukcion i rrugës Tre çezmat-Zerqan (Faza I)
7. **Z. J.L.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë) për procedurën e prokurimit me objekt:

– “Ndërtim Ujësjiellësi në fshatin Zall-Sopot dhe ndërtim murre guri, kanale betoni dhe rruge auto, ndërtim vend depozitimi për mbetjet urbane, rrethim lulishtja në fshatrat e Komunës”.

a) Në tenderin me objekt: **“Rikonstruksion i rrugës Tre çezmat –Zerqan (Faza I)**, zhvilluar më datë 13.08.2012, kontrata lidhur datë 11.09.2012 me fond limit 52,561,167 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, u konstatua se:

Në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit ka mangësi pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderit.

Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve **në vlerën 16,625,538 lekë**, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

**Janë s`kualifikuar 4 OE të cilët kanë oferta më të ulëta nga 4 OE e tjerë që janë kualifikuar.**

Në përfundim në auditimin e këtij tenderi, u konstatuan se ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, **në vlerën (52009441-35383903)=16,625,538 lekë.**, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 1, 2, 24 dhe pikën 4, të neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

b) Në tenderin me objekt: **“Ndërtim Ujësjiellësi në fshatin Zall-Sopot dhe ndërtim murre guri, kanale betoni dhe rruge auto, ndërtim vend depozitimi për mbetjet urbane, rrethim lulishtja në fshatrat e Komunës**”, zhvilluar më datë 24.04.2014, kontrata lidhur datë 28.05.2014 me fond limit 4,831,894 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, u konstatuan shkeljet e mëposhtme:

Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve **në vlerën 159,395 lekë**, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

OE XXXXXXXXXX i shpallur edhe fitues, nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me eksperiencën e drejtuesit teknik, në kundërshtim me DST ku është kërkuar që “Drejtuesi Teknik duhet të ketë një përvojë pune prej **5 vjet**, të shoqëruar me: Diplomë, Libreze pune & CV dhe Kontratë pune të vlefshme” për arsye se ofertuesi nuk ka përvojë pune 5 vjeçare.

OE tjetër konkurrues “XXXXXXXXXX” sh.p.k është skualifikuar nga KVO për mungesë dokumentacioni. Nga verifikimi u konstatua se OE “XXXXXXXXXX” ka plotësuar kriteret e

përgjithshme të pranimit kualifikimit dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

Në përfundim në auditimin e këtij tenderi, u konstatuan se ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, **në vlerën (4831895-4672499)= 159,395 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

#### **IV. Ish- Komuna Ostren, për 6 punonjës si më poshtë:**

1. **Z. Xh.Sh.** me detyrë ish specialist, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë)
2. **Z. S.P.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
3. **Z. Q.M.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
4. **Z. B.H.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
5. **Z. F.A.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
6. **Z. A.M.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).

Për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt: **“Rikonstruktion i shkollës 9 –vjeçare Ostren i Madh”**, zhvilluar më datë 25.09.2012, kontrata lidhur datë 2.11.2012 me fond limit 6,590,406 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “” shpk, sa vijon:

NJHDT nuk ka vendosur saktë kërkesat e veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi, bazuar në përcaktimet e bëra në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.

NJHDT nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve në vlerën 1,907,017 lekë, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

OE fitues, “” shpk, nuk ka plotësuar pikën 5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi “Disponimi ose mundësia e sigurte e disponimit ne pasjet/kapacitetet e me poshtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, psi për të gjitha mjetet me goma duhet të kenë leje qarkullimi,taksa dhe detyrimet te paguara dhe leje bashkie/komune”, për arsye se: mjeti me KAMION me targë DI 4723 A dhe KAMIONÇINE me targë DI 4523 AA, nuk plotësojnë kapacitetin e kërkuar në DST kamion mbi 2 dhe 8 ton, mjeti KAMION me targë DI 1975 A nuk ka taksa dhe detyrimet te paguara dhe leje bashkie/komune dhe mjetet kamion MAN nuk ka leje qarkullimi, taksat dhe detyrime të paguara dhe leje bashkie /komune, për rrjedhojë kualifikimi i OE është bërë në kundërshtim me LPP, RrPP dhe Dokumentet Standarde të Tenderit shtojca 9 “Kriteret e përgjithshme të pranimit kualifikimit”.

Kualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “” sh.p.k, është kryer në



kundërshtim me VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa ç. KVO duhej të kishte ndërprerë procedurën e prokurimit dhe të kërkonte fillimin e një procedure të re sipas përcaktimeve të bëra në VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu VII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1 “Mungesa e konkurrencës”, germa a.

Veç kësaj KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët se ofertat fituese, e për pasojë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër në vlerën në vlerën 1,907,017 lekë. Gjithashtu ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues OE “XXXXXXXXXX” në kundërshtim me Neni 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç.

Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë **që 1,907,017 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

#### **V. Ish- Komuna Trebisht, për 6 punonjës si më poshtë:**

1. **z A.M.** me detyrë ish specialist, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë)
2. **Z. R.S.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
3. **Z. S.S.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
4. **Z. V.C.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
5. **Z. F.S.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).
6. **Zj. K.A.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë).

a) Për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt: **“Ndërtim Kanalizime Ujërave të Zeza për fshatrat Celibi-Muçini-Bala”**, zhvilluar më datë 03.12.2014, kontrata lidhur datë 16.12.2014 me fond limit 20,605,235 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, *sa vijon:*

NJHDT nuk ka vendosur saktë kërkesat e veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi, bazuar në përcaktimet e bëra në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.

NJHDT nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës.

Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave.

- b) Për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt: **“Ujësjetës i fshatrave Bala, Muçinë, Çelebi Trebisht”**, zhvilluar më datë 28.07.2014, kontrata lidhur datë 15.08.2014 me fond limit 8,017,780 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, sa vijon:

NJHDT nuk ka vendosur saktë kërkesat e veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi, bazuar në përcaktimet e bëra në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.

NJHDT nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave.

## **VI. Për Ish -Komuna Gjoricë, për 8 punonjës si më poshtë:**

1. **Zj. P.K.** me detyrë ish specialist, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë),
2. **Z. H.Xh.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë),  
për procedurën e prokurimit:
  - *“Furnizim me ujë i disa fshatrave të Komunës Ostren dhe fshatrave Vicisht-Cerenec i Epërm Cerenet i Poshtëm- Gjoricë e Epërme dhe Gjoricë e poshtme të Komunës Gjoricë” Qarku Dibër (Faza e parë Kaptazhet, Linja e Transmetimi”;*
3. **Z. A.K.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë) për procedurat e prokurimit me objekt:
4. **Z. Zh.D.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHDT (aktualisht jashtë institucionit pa adresë)
5. **Z. F.C.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë)
6. **Z. Z.G.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO dhe anëtarit të NJHDT(aktualisht jashtë institucionit pa adresë) për procedurat e prokurimit me objekt:
  - *“Furnizim me uje i disa fshatrave të Komunës Ostren dhe fshatrave Vicisht-Cerenec i Epërm Cerenet i Poshtëm- Gjoricë e Epërme dhe Gjoricë e poshtme të Komunës Gjoricë” Qarku Dibër (Faza e parë Kaptazhet, Linja e Transmetimi”;*
  - *“Riparim Asfaltime të Rrugës ekzistuese Ura e Cerenecit-Qendër Gjoricë”;*
7. **Z. V.H.** me detyrë ish-specialist, në cilësinë e kryetarit të KVO (aktualisht jashtë institucionit pa adresë ) për procedurën e prokurimit
  - *“Riparim Asfaltime të Rrugës ekzistuese Ura e Cerenecit-Qendër Gjoricë”;*
8. **zj. Zh.D.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të NJHD (aktualisht jashtë institucionit pa adresë), për procedurat e prokurimit me objekt:
  - *“Furnizim me ujë i disa fshatrave të Komunës Ostren dhe fshatrave Vicisht-Cerenec i Epërm Cerenet i Poshtëm- Gjoricë e Epërme dhe Gjoricë e poshtme të Komunës Gjoricë” Qarku Dibër (Faza e parë Kaptazhet, Linja e Transmetimi”;*
  - *“Riparim Asfaltime të Rrugës ekzistuese Ura e Cerenecit-Qendër Gjoricë”;*

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

- a) Në tenderin me objekt: **“Furnizim me uje i disa fshatrave të Komunës Ostren dhe**

*fshatrave Vicisht-Cerenec i Epërm Cerenet i Poshtëm- Gjoricë e Epërme dhe Gjoricë e poshtme të Komunës Gjoricë” Qarku Dibër (Faza e parë Kaptazhet, Linja e Transmetimi”, zhvilluar më datë 30.06.2015, kontrata lidhur datë 10.07.2015 me fond limit 83,288,008 lekë pa tvsh dhe i fituar nga BOE “ [REDAKTUAR] & [REDAKTUAR]” shpk, u konstatua:*

Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar mënyrën e llogaritjes së vlerës limit të kontratës për disa zëra të punimeve të në preventiv janë shënuar “an”. AK nuk ka hartuar analiza për të dokumentuar mënyrën e llogaritjes së çmimit për njësi. Gjithashtu, për zërin “vepër e marrjes së ujit (kaptazhi) nuk jepet referenca se nga është marrë çmimi për njësi i përdorur. Në preventiv përcaktohet edhe zëri patinim me stuko veneciane, e cila nuk ka lidhje me objektin e kontratës, sepse ky zë është për punime dekorit dhe jo për punime ujësjellësi siç janë punimet objekt i kontratës gjë që konsiderohet shpenzim i tepërt.

Në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit ka mangësi të theksuara, për arsye se: kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderit.

Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve **në vlerën 29,990,205 lekë**, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

AK ka hartuar kriteret e pranimit në kundërshtim me dispozitat e prokurimit si vijon:

NJP ka kërkuar ndërmjet të tjerave edhe licencat sipas këtyre kategorive: NP-1C, NP-5B, NP 6-A. NS-19 B dhe NS20-A, të cilat nuk përputhen me natyrën dhe vlerën e punimeve objekt kontrate. Theksojmë se, vendosja e këtij kriteri është e pa argumentuar nga AK dhe si i tillë, ky kriter ka çuar në kufizimin e pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi në kundërshtim me qëllimet kryesore të LPP, RrPP dhe DST-Punë.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “ [REDAKTUAR]” kanë kontrata pune në vazhdim gjë që BOE është kualifikuar në kundërshtim me pikën 1, të nenit 53 LPP, dhe neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të RrPP dhe DST (kriteret e veçanta të kualifikimit) si dhe nuk kanë paraqitur asnjë dokument për plotësimin e pikë 8, të kriterëve të veçantë të kualifikimit ku NJP ka kërkuar analiza çmimi për të gjitha zërat e preventivit.

KVO nuk ka verifikuar dokumentacionin origjinal të ofertuesit fituese në kundërshtim me UAPP nr. 8 , datë 22.05.2015.

KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikimit-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues BOE “ [REDAKTUAR]” në kundërshtim me Neni 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik” dhe neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave i VKM “Për Rregullat e Prokurimit Publik”.

Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë

dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që **29,990,205 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

**Në këtë procedurë tenderi, kanë marrë pjesë** Operatori ekonomik “██████████” sh.p.k, Operatori ekonomik “██████████” Sh.p.k, Operatori ekonomik “██████████” sh.p.k, Operatori ekonomik “██████████” Sh.p.k të kualifikuar me mungesa në dokumentacion.

- b) Në tenderin me objekt: **“Riparim Asfaltim të Rrugës ekzistuese Ura e Cerencit-Qendër Gjoricë”**, zhvilluar më datë 8.10.2014, kontrata lidhur datë 22.10.2014 me fond limit 6,666,667 lekë pa tvsh dhe i fituar nga OE “██████████” shpk, u konstatua:

NJHDT nuk ka vendosur saktë kërkesat e veçanta të kualifikimit, bazuar në përcaktimet e bëra në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.

NJHDT nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, sipas Rregullave të Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve **në vlerën 1,488,057 lekë**, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

**OE fitues**, nuk ka plotësuar pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” për sa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale për përvojën e suksesshme në ekzekutimin punimeve të ngjashme

**OE tjetër pjesëmarrës me vlerë të ofertës 5,167,453 lekë, është s`kualifikuar për mungesa në dokumentacion.**

KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterit të kualifikimit pranimit të operatorëve pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues OE “██████████” sh.p.k në kundërshtim me Neni 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç.

Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që **vlerën 1,488,057 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

**Shënim: Për punonjësit e larguar dhe nuk kanë adresë:**

*Për 15 ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.*

*Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, përkatësisht:*

- 1) **Z. A.L.** me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës Bashkia Bulqizë, larguar nga detyra më datën 24.07.2013,
- 2) **Z. S.K.** me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës Bashkia Bulqizë, larguar nga puna më datën 10.02.2015,
- 3) **Z. P.K.** me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës Urbanistikës Bashkia Bulqizë, larguar me datë 25.08.2015,
- 4) **Z. O.V.** me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës Urbanistikës Bashkia Bulqizë, larguar më datë 16.02.2016,
- 5) **Z. M.LI.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Shupenzë,
- 6) **Zj. J.K.** me detyrë ish Shef i Financës, Komuna Zerqan,
- 7) **Z. G.K.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Martanesh,
- 8) **Zj. S.C.** me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës Financës, Komuna Martanesh,
- 9) **Zj. A.H.** me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës, Komuna Martanesh,
- 10) **Z. R.R.** me detyrë ish kryetar i Komunës Ostren,
- 11) **Z. Sh.K.** me detyrë ish p/zyrës së financës Komuna Ostren,
- 12) **Z. K.H.** me detyrë ish p/zyrës së financës Komuna Zerqan,
- 13) **Z. A.Sh.** me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të taksave Bashkia Bulqizë,
- 14) **Z. H.H.** me detyrë ish Inspektor i Policisë Bashkiake.
- 15) **Z. A.T.** me detyrë ish zv/kryetar i Bashkisë për periudhën deri në Korrik 2013.

## **E. TË TJERA**

**E.1.** Në funksion të garantimit të paanësisë së punës audituese të KLSH-së, nisur nga disa informacione të përcjella në Kontrollin e Lartë të Shtetit përpara hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ish-Kryetari i Komunës Gjoricë, gjetjet dhe konstatimet e evidentuara në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me ish-Komunën Gjoric (aktualisht njësi administrative në varësi të Bashkisë Bulqizë), nuk do të përfshihen në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, pavarësisht faktit që sipas kontrollit të bërë nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, këto gjetje dhe konkluzione qëndronin, por i kërkojmë Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Bulqizë:

Në zbatim të nenit 15, shkronja (i) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 1600 dhe nenit 25 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Bulqizë, në bazë të një programi auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të auditojë më tej, të gjitha gjetjet e konstatuara dhe evidentuara në fq. 126-145 të Projekt Raportit të Auditimit të KLSH-së, dërguar Bashkisë Bulqizë me shkresën nr. 574/4, datë 2.8.2016, përpara i përket ish-Komunës Gjoricë, për 5 procedurat e prokurimit publik të mëposhtëm me objekt:

- 1) “Furnizim me ujë të pijshëm i disa fshatrave të Komunës Ostren dhe fshatrave Viçisht-Çerenec i Epërm-Çerenec i Poshtëm-Gjoricë e Epërme dhe Gjoricë e Poshtëme të Komunës Gjotocë, (Faza e parë Kaptazhet, linja e transmetimit”. Fondi limit 83,288,008 lekë, zhvilluar datë 30.06.2015.
- 2) “Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestere, Komuna Gjoricë”. Fondi limit 32,579,775 lekë, zhvilluar datë 03.09.2014.
- 3) “Ndërtim i rrjetit të KUZ fshati Çerenec i Poshtëm, 2 Lagjet, L= 1200 m Komuna Gjoricë”. Fondi limit 2,531,279 lekë, zhvilluar datë 21.06.2014.
- 4) “Riparime, asfaltime të rrugës ekzistuese Ura e Çerenecit-Qëndër Gjoricë”. Fondi limit 6,666,667 lekë, zhvilluar datë 08.10.2014.
- 5) “Mirëmbajtje kanalesh ujitës, Vija e Re Lubanesh, kanali ujitës Vija e Mullirit”. Fondi

limit 1,666,660 lekë, zhvilluar datë 19.04.2013.

Një kopje e Raportit Final të Auditimit dhe përfundimet në lidhje me të, ti dërgohen Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda vitit 2016.

- E.2.** Sa më sipër, bazuar edhe në përcaktimet e bëra në Urdhrin nr. 94, datë 30.08.2016 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për fillimin e procedurave disiplinore ndaj njërit prej anëtarëve të grupit të auditimit si dhe kontrollin në të nxehtë të veprimtarisë audituese, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor do të planifikojë në të ardhmen, si pjesë të planit vjetor të auditimeve, auditimin e plotë të gjitha procedurave të prokurimit publik në Bashkinë Bulqizë dhe ish-Komunën Trebisht.

## **F. PËR VLERËSIM NGA ORGANI I PROKURORISË**

Nisur nga fakti që shkeljet e konstatuara në këtë Raport Auditimi i përkasin një sërë subjektsh auditimi (ish-Komunave tashmë njësi administrative të Bashkisë Bulqizë) dhe fakti që këto shkelje i atribuohen një numri të konsiderueshëm ish-punonjësish dhe punonjësish aktual, duke mos dashur përjashtimin nga përgjegjësia penale të cilitdo prej këtyre punonjësve por edhe rëndimin me pa të drejtë të tyre, veçanërisht atyre të nivelit drejtues, Raporti Përfundimtar i Auditimit do të përcillet organit të Prokurorisë për vlerësim paraprak nga ana e tij.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**K R Y E T A R**

**Bujar LESKAJ**